



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMORI LËNDËS
Morfologji e Gjuhës Greke

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore, 4 kredite: (20 leksione, 20 seminare)

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe Interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Objektivat e kësaj lënde janë të pajisin studentët me një kuptim të thellë dhe të plotë të gramatikës dhe morfologjisë së gjuhës greke, duke u bazuar në analizën dhe përdorimin praktik të strukturave gjuhësore. Lënda synon të zhvillojë aftësitë e studentëve për të kuptuar dhe zbatuar njohuritë mbi emrat, foljet, mbiemrat, përemrat, ndajfoljet dhe ndërtimin e fjalive të thjeshta dhe të përbëra. Gjithashtu, ka për qëllim përmirësimin e kompetencës së studentëve në përdorimin e saktë të gjuhës në kontekste të ndryshme praktike dhe akademike.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të përvetësojnë njohuritë mbi klasifikimin gramatikor të emrave, foljeve dhe ndajfoljeve.
2. Të analizojnë dhe përdorin përemrat dhe mbiemrat në kontekste të ndryshme.
3. Të identifikojnë dhe shpjegojnë funksionin e parafjalëve dhe lidhëzave.
4. Të kuptojnë ndërtimin dhe funksionin e fjalive komplekse.

Rezultatet e pritshme:

1. Përdorin saktë emrat dhe përemrat në fjali.
2. Formojnë dhe analizojnë fjalitë me folje të ndryshme.
3. Shquajnë dhe krahasojnë strukturat sintaksore në greqisht dhe shqip.
4. Aplikojnë konceptet morfologjike për të përmirësuar aftësitë e tyre në greqisht.